



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

V E N D I M

Nr. 35, Datë 24/02/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 10, datë 10.02.2021, e z. V. M., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*moshës*”, “*etnisë*”² dhe për “*çdo shkak tjetër*”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri³,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesi është pensionit në moshën 87 vjeçare dhe i përket pakicës kombëtare greke. Ai ka dalë në pension në vitin 1994 dhe pretendon se masa e pensionit i ka dalë më e ulët sesa kolegëve të tij. Ankuesi ka sqaruar se para 10 vjetëve ka depozituar kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për të sqaruar çështjen dhe ky institucion i ka kthyer përgjigje zyrtare. Për sa më sipër, ai pretendon se është paraqitur disa herë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, por nuk është sqaruar mirë, lidhur me këtë çështje. Z. V. M. kërkon të jetë në dijeni të faktit se si është llogaritur masa e pensionit të tij dhe përse ish-kolegët e tij⁴ marrin pension në masën 20.000 lekë, ndërkohë që ai merr pension në masën 15.000 lekë. Për sa më

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Ankuesi pretendon se i përket pakicës kombëtare greke në Shqipëri;

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

⁴ Ankuesi nuk ka pranuar të japë informacion, edhe se është kërkuar nga KMD, se cilët ish-kolegë të tij kanë pension në masë më të madhe se ankuesi, edhe pse ndodheshin në kushte të njëjta me të;

sipër, ankuesi pretendon se diskriminohet për shkak të etnisë, moshës, si dhe për çdo shkak tjetër.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

- A.** Pas depozitimit të ankesës nr. 10, datë 10.02.2021, strukturat përkatëse të Komisionerit kontaktuan me telefon me ankuesin, ku iu kërkuan disa dokumente plotësuese, si dhe disa sqarime në lidhje me ankesën.

Ndër të tjera, ankuesit iu kërkua informacion mbi periudhën kohore përgjatë së cilës, ai ka patur korrespondencë zyrtare me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Në këtë kontekst, ai sqaroi se korrespondenca zyrtare me këtë ky institucion datonte para 10 vitesh. Z. V. M. iu kërkua të identifikonte disa prej ish-kolegëve të tij, të cilët edhe pse ndodheshin në të njëjtat kushte me të, kishin përfituar masë më të madhe pensioni. Ankuesi refuzoi të jepte informacion dhe krahasimin e masës së pensionit e lidhi me bashkëshorten e tij dhe me njerëz të afërm. Z. V. M. iu kërkua të dërgonte pranë KMD-së korrespondencën zyrtare me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, kopje të librezës së punës, kopje të plotë të librezës së pensionit, si dhe aktin nëpërmjet, së cilit vërtetohet etnia e tij.

Dokumentacioni plotësues nuk u dërgua nga ankuesi.

B. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 10, datë 10.02.2021, KMD konstatoi se:

Në ankesën nr. 10, datë 10.02.2021, e z. V. M., pretendohet diskriminim për shkak të “moshës”, “etnisë” dhe për “çdo shkak tjetër”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Nga analizimi i ankesës së depozituar nga ankuesi rezulton se ai ka dalë në pension në vitin 1994. Korrespondenca shkresore me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë daton rreth 10 vjet më parë. Njëkohësisht, Komisioneri konstatoi se në formularin e ankesës, ankuesi nuk ka deklaruar data të sakta, lidhur me momentin e ndodhjes dhe konstatimit të diskriminimit.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “etnisë”, “moshës” dhe “për çdo shkak tjetër” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e

parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 20, pikat 1 dhe 2, gërma c), të LMD, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:.....2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:.....c) Kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 33, pika 4, gërmat d) e dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se nuk pranohen ato ankesa kur: (1) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese.

Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se ligji nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka hyrë në fuqi në vitin 2010 dhe ankuesi ka dalë në pension në vitin 1994, pra para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Njëkohësisht, Komisioneri konstatoi se momenti, kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar, si dhe momenti i marrjes dijani mbi të,

gjithashtu datojnë më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese. Ankuesi nuk ka depozituar asnjë fakt dhe provë që ka kryer veprime të mëtejshme, lidhur me çështjen e masës së pensionit të tij, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, nenin 20, pikat 1 e 2, gërma c), nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërmat d) e dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 10, datë 10.02.2021, së z. V. M.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Të mira e shërbime
Shkak – mosha, etnia, çdo shkak tjetër
Lloji vendimit - Mospranim